

AKT THEMELIMI
I Shoqerise Tregtare TOGO sh.p.k

Sot me 21.9.2020 mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne fuqi te Republikes se Shqiperise, ne Ligjin Nr.7512 date 10.08.1991, "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit", te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008, "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare", me vullnetin e tij te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ortakët:

Andi Shkëmbi, lindur ne Mamurras, me 6/5/1992, i biri i Zeni Shkëmbi dhe Luljeta Shkëmbi, banues ne Tirane, Rr."Jordan Misja", Kompleksi "Gener 2".

Florian Nanagjoka, lindur në Tiranë më 22/11/1982, i biri I Dashamir Nanagjoka dhe Sanije Nanagjoka, banues në Tiranë, Rr. "Thoma Koxhaj", Pallati "Agolli" SHk. C, Tiranë

Vendosën te krijojne shoqerine tregtare me perjegjesi te kufizuar "TOGO" sh.p.k me akt themelimi si vijon.

Neni 1
Formulimi

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur TOGO shpk. Shoqeria do t'i nenshtrohet Legjislacionit Shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do t'i nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelimi dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

Neni 2
Selia e Shoqerise

Selia e shoqerise tregtare private TOGO shpk do te kete seline ne rrugen "Rreshit Petrela", Kompleksi "Usluga", Godina D, kati 7, Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese dhe ortakut te vetem.

Neni 3
Objekti i Veprimitarise

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat qe vijojne: Zhvillim software ne te gjitha platformat per web, desktop, mobile etj duke perfshire proceset e analizes, dizajn, planifikim, implementim, mirembajtje. Zhvillim ose ndermjetesim ne trajnime dhe kurse profesionale ne fushen e zhvillimit te software dhe Teknologjise se Informacionit. Konsulencë ne fushen e zhvillimit software ne platforma te ndryshme. Disenjim dhe zhvillim sistemesh te komunikimit. Ketu perfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja ne pune dhe mirembajtja e sistemeve te komunikimit te rrjeteve te pajisjeve informatike. Disenjim dhe zhvillim sistemesh te sigurise. Zhvillim sistemesh migrimi. Ketu perfshihet transferimi i te dheneve dhe infrastruktureve perkatese nga një teknologji e vjeter ne një teknologji te re; Permiresim / upgrade sistemesh



informatike; Operimi, menaxhimi, suporti i perdonimit, trajnimi dhe auditimi Teknik / informatik per sistemet software. Tregtim dhe shitje me shumice dhe pakice i produkteve elektrike, telefonike, industriale. Ofrimin e sherbimeve te komunikimit dhe marketingut, duke perfshire reklamat apo aktivitete qe lidhen me marredheniet me publikun si dhe sherbimet ne lidhje me promovimin e shitjeve & eveneteve. Realizimin e aktivitetave ne fushen e publicitetave, reklamave, botimeve, medias dhe turizmit. Keto sherbime perfshijne por pa u kufizuar vetem ne to: pergatitjen, prodhimin apo pershtatjen e reklamave per median audiovizive; blerjen dhe planifikimin mediatik, si dhe prodhimin e materialeve publicitare dhe kryerjen e aktivitetave e materialeve BTL. Pergatitjen, prodhimin, realizimin dhe mirembajtjen e faqeve te internetit dhe mediave sociale si dhe manaxhimin e fushatave reklamuese online. Grumbullim te dhënash dhe statistika (sondazhe, testim tregu; reklamim telefonik, etj). Konsulencë në fushat e mësipërme

Neni 4 Kohezgjatja e Shoqerise

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar. Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku.

Neni 5 Kapitali i Shoqerise

Kapitali fillestari i Shoqerise private "TOGO" sh.p.k do te jete 1 000 000 Leke (njëmillion leke). Ai eshte i ndare ne pjese me vlere nominale prej 670 000 (Gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) Leke dhe 330 000 (Treqind e tridhjetë e tre mijë) Lekë.

Ortaku themelues të shoqërisë janë Z. Andi Shkëmbi, i cili zotëron 67% të kutoave të kapitalit themeltar dhe Z. Florian Nanagjoka, i cili zotëron 33% të kuotave të kapitalit themeltar.

Neni 6 Drejtimi i Shoqerise

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj, Z. Andi Shkëmbi, ortaku me 67% të kuotave të kapitalit themeltar dhe perfaqesuesi ligor i saj. Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetencia te plota ne drejtimin e saj. Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme.

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakëve, bazuar në kuotat e kapitalit themeltar që ata zotërojnë. Z. Andi Shkombi do të përfitojë 67% të të ardhurave neto të shoqërisë. Z. Florian Nanagjoka do të përfitojë 33 % të të ardhurave neto të shoqërisë.

Neni 8

Ortakët Z. Andi Shkëmbi dhe Z. Florian Nanagjoka kanë te drejte te emerjone dhe administratore te tjere te vlerave materiale. Kanë te drejte te caktojne financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtojne persona te tjere si ortake.

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatene Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rrerh saj.

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerishte te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri.


Neni 12

Akti i themelimit u perpilua ne 3 kopje, per t'u shpendare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise TOGO sh.p.k.

Akti i themelimit nenshkruehet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

Ortakët themelues të TOGO sh.p.k

ANDI SHKEMBI

Andi Shkembi


FLORIAN NANAGJOKA

Florian Nanagjoka
